

VENDIM
Nr. 6660, datë 5.4.2019

NË EMËR TË REPUBLIKËS
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:
Gjyqtar: ENEIDA CIVICI

asistuar nga sekretare gjyqësore **Anjeza Nergjoni**, sot më datë **5.4.2019**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile-tregtare me **nr. 6660 Regj. Themeltar**, që i përket:

KËRKUES: “TTSGA” sh.a. e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër NIUS K51313001H, me seli në adresën: “Rruga e Dibrës”, pallat i ri 5-katësh, kati i dytë, përbri Medresesë, ngjitur me Klinikën Ortodokse, Tiranë, Shqipëri.

OBJEKTI: Fillimin e procedurës së falimentit për pasuritë e shoqërisë “TTSGA” sh.a. për shkak të paaftësisë paguese.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 110/2016, datë. 27.10.2016, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306-308 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 29 e vijues të ligjit 110/2016, “Për falimentimin”,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuetit, shoqëria “TTSGA” sh.a.
2. Hapjen, më datë 5.4.2019, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a. me administrator z. Mateos Zoto, me veprimtari “organizim lojërash fati”, me NIUS K51313001H dhe me seli në adresën “Rruga e Dibrës”, pallat i ri 5-katësh, kati i dytë, përbri Medresesë, ngjitur me Klinikën Ortodokse, Tiranë, Shqipëri.
3. Caktimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “TTSGA” sh.a., të znj. Shpresa Breçani, e datëlindjes 20.3.1964, me nr. personal G45320378H, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë me licencën nr. 09, datë 16.10.2012, me NIPT K71529023K, me adresë: Rruga “Panorama” (ish-rruga “Jordan Misja”), pall. Sara-El, kati i dytë, pranë Hipotekës, Tiranë, dhe me cel: 0682094103.
4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “TTSGA” sh.a., të paraqesin pretendimet e tyre tek administratori i falimentimit brenda 45 ditëve nga publikimi i këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
5. Çdo person fizik apo juridik, i cili ka detyrime ndaj debitorit shoqëria “TTSGA” sh.a., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratorit të falimentit.
6. Caktimin e një komiteti të përkohshëm të kreditorëve, në përputhje me nenin 29, pika “dh”, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, duke u caktuar si anëtarë të këtij komiteti Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, si kreditor të pasiguruar dhe si kreditor i preferuar punonjësi ndaj të cilit kërkueti ka detyrimin më të lartë.
7. Mbledhja e raportimit do të mbahet në datë 20.6.2019, ora 10:00.
8. Urdhërohet botimi i një kopjeje të shkurtuar të këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit shoqëria “TTSGA” sh.a., në faqen elektronike të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.
9. Ky vendim i njoftohet debitorit shoqëria “TTSGA” sh.a., administratores së falimentit znj. Shpresa Breçani.
10. Administratori i falimentit i komunikon një kopje të këtij vendimi të gjithë kreditorëve të njohur të shoqërisë “TTSGA” sh.a.
11. Administratori i falimentit është i detyruar të bëjë regjistrimin e vendimit sipas nenit 32 të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin” në të gjitha regjistrat publikë ose institucione të tjera financiare ku janë të regjistruara pasuri ose të drejta të tjera të debitorit.

12. Administratori i falimentit do të shpërblehet sipas VKM-së nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentit”.

13. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

14. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmeja e komunikimit të tij.

U shpall, sot më datë 5.4.2019

Sekretare
Anjeza Nergjoni

Gjyqtare
Eneida Civici